

**Drejtuar:** **Z. Damian GJIKNURI**  
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

**Znj. Ogerta MANASTLIRLIU**  
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Z. Arben AHMETAJ**  
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

**Për dijeni:** **Z. Edi RAMA**  
Kryetar i Këshillit të Ministrave

**Z. Petrit AHMETI**  
Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë

**Z. Adrian ÇELA**  
Administrator i shoqërisë “OSHEE” sh.a

**Z. Robert GAJDA**  
Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**Znj. Erinda BALLANCA**  
Avokate e Popullit

**Lënda:** Kërkesë për seancë dëgjimore dhe ofrim rekomandimesh për draftimin e akteve nënligjore, në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”

### **Të nderuar,**

Në kuadër të angazhimit shumë vjeçar në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë përmes Qendrës së Ligjit Tiranë, ka kryer një studim mbi aksesin në furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në nevojë duke synuar të vlerësojë situatën aktuale dhe të propozojë ndryshime në nivel politikash, që do të garantojnë mbrojtjen efektive të të drejtave social-ekonomike të kësaj kategorie.

Ky dokument synon propozimin dhe argumentimin e një mekanizmi, i cili do të siguronte zbatimin efikas të nenit 95 të Ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjise elektrike*”, si dhe mbështetjen e familjeve të varfra për të përmbushur nevojat bazë të cilat lidhen me aksesin në energjinë elektrike. Ky ligj njih ne menyre eksplicite konceptin e “klientit në nevojë” dhe trajtimin e tyre te diferencuar dhe tashme kerkohet nga institucionet pergjegjese shteterore marrja e masave ne nivel politikash per ta adresuar kete ceshtje.

Vitet e fundit janë bërë përpjekje në disiplinimin e sektorit të energjisë elektrike të cilat kanë siguruar rezultate pozitive në performancën financiare të sektorit, por nga ana tjetër në mungesë të një skeme mbrojtje efikase janë shkaktuar pasoja të rënda ndaj të drejtës për

aksesin në energjinë elektrike për familjet e varfra gjë që ka kontribuar në vështirësi serioze të përmbushjes së nevojave bazë të lidhura me ndriçimin, aksesin në informacion, ruajtjen e shëndetit etj. Pavaresisht se janë aplikuar skema lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, mbrojtja sociale dhe ekonomike e kesaj kategorie nuk është e mjaftueshme.

Më poshtë paraqiten disa të dhëna zyrtare të mbledhura nga korrespondenca me institucione të ndryshme të cilat ndihmojnë për të kuptuar më qartë situatën.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në periudhën Nentor – Dhjetor 2017 rezultojnë 82,076 familje të cilat përfitojnë ndihmën ekonomike, ndërkohë që vetëm 33,012 prej tyre kanë përfituar nga kompensimi i energjisë elektrike i vendosur si pasoje e heqjes së fashës mbrojtëse prej 300 KWH gjatë vitit 2015<sup>1</sup>. Ndërkohë që sipas shifrave të Ministrisë, në muajin Janar 2018 numri i familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike ra në 52,000 familje, ndërsa në muajin u rrit në 54,000 përfitues.

Sipas të dhënave të OSHEE, aktualisht janë në fuqi 20,112 aktmarrëveshje të lidhura me abonentë familjarë që trajtohen me ndihmë ekonomike. Ndërkohë, 10,646 aktmarrëveshje të tjera të lidhura me abonentë të cilët trajtoheshin me ndihmë ekonomike në momentin e lidhjes së aktmarrëveshjeve, konsiderohen me probleme pasi abonentët nuk kanë përmbushur shlyerjen e rregullt të kësteve. Kjo përbindje e lartë tregon se ekzistojnë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare për shlyerjen njëherazi të debisë dhe faturës korente të energjisë elektrike. Në këtë vështirësi kontribuon dhe efikasiteti i ulët i skemës aktuale të kompensimit të energjisë elektrike si pasojë e heqjes së fashës mbrojtëse pasi vetëm 40% e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike arrijnë që të përfitojnë nga kompensimi.

Në rrethanat aktuale pamundësia për të paguar detyrimet e faturave të energjisë elektrike çon në ndërprerjen e energjisë, gjë që përkeqëson kushtet e jetesës së familjeve. E drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore të njeriut dhe rrjedh nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese (neni 25 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut). E drejta për energji elektrike gjithashtu është formuluar si një atribut në kontekstin e të drejtës për mosdiskriminim (në veçanti në lidhje me gratë, popullsinë rurale, grupet e pakicave të përjashtuara) dhe në kontekstin e së drejtës për zhvillim.

Në ato raste kur rilidhja është kryer në mënyrë të paligjshme, kryefamiljari ndalohej, arrestohet dhe ndiqet penalisht, duke rënduar më tej situatën e familjes, sikurse dhe buxhetin e shtetit nëse do të mbanim parasysh koston e procesit të gjyqimit si dhe shpenzimet publike dhe private të lidhura me vuajtjen e dënimit. Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë rezultojnë se në vitin 2016 janë evidentuar 1270 vepra penale në shkallë vendi të lidhura me vjedhjen e energjisë elektrike dhe nga këta 368 janë arrestuar, 58 ndaluar, 606 janë ndjekur në gjendje të lirë dhe 255 shpallur në kërkim. Gjatë vitit 2017 janë evidentuar - 740 vepra penale - 123 arrestuar, 13 ndaluar, 493 ndiqen në gjendje të lirë dhe 130 shpallur në kërkim. Sipas Prokurorisë së përgjithshme gjatë vitit 2016 janë regjistruar 597 kallëzime; 587 procedime ndërsa 543 çështje janë dorëzuar për gjykim. Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 243 kallëzime; 215 procedime ndërsa 160 çështje janë dorëzuar për gjykim.

Gjykojmë se zbatimi i një skeme që do të bënte të zbatueshëm nenin 95 të Ligjit 43/2015 “*Per sektorin e energjisë elektrike*” do të siguronte njëherazi një arkëtim të përmirësuar të detyrimeve të energjisë elektrike si pasojë e krijimit të kushteve për abonentët në nevojë për t’ju përgjigjur detyrimit financiar; sikurse do të ndikonte në uljen e shpenzimeve publike në

---

<sup>1</sup> VKM nr 8/2015 “Për kompensimin e Energjisë Elektrike”

funkcion të dënimit të kundravajtësve të shtyrë nga pamundësia ekonomike për të përballuar faturën e energjisë elektrike.

**Ne lidhje me rrethin e subjekteve që duhet të përfitojnë statusin e klienteve në nevojë** sugjerojmë që të mbahet në konsideratë një perkufizim i cili përfshirë të gjithë abonentët familjarë me të ardhura mujore totale nën nivelin e pagës minimale.

Për të arritur tek skema e cila do të siguronte një qasje më të drejtë të abonentëve familjar në shërbimin me energji elektrike lind nevoja e arsytimit të **konsumit minimal të domosdoshëm të energjisë elektrike për një familje mesatare**. Vleresimin e konsumit minimal të domosdoshëm të energjisë elektrike për konsum familjar bazohet në strukturën e familjes së sotme shqiptare pasi sipas INSTAT familja mesatare përbëhet nga 4 persona, një çift bashkeshortor dhe dy fëmijë.

Aktualisht për vitin 2017 nga të dhënat e OSHEE sh.a rezultojnë një numër total prej 1,292,496 abonentesh, nga të cilët numri total i abonenteve familjare është 1.038.353 ose 80% e totalit të abonenteve.

Fashat e konsumit të energjisë elektrike për abonentët familjarë janë si më poshtë:

- 0 kwh 231.215 abonente
- 1-50 kwh 88.808 abonente
- 51-100 kwh 90.543 abonente
- 101-200 kwh 231.642 abonente
- 201-300 kwh 180.962 abonente
- 301-400 kwh 104.739 abonente
- 401-600 kwh 87.207 abonente

Përgjatë vitit 2017 në total vjetor OSHEE sh.a ka patur një nivel humbesh prej 26.41 % , në këto vlera përfshihen humbjet teknike (ku përfshihen humbjet e energjisë si shkak i rrjetit dhe i amortizimit të pajisjeve komutuese) dhe ato joteknike (ku përfshihen vjedhjet e energjisë). Numri total i ndërprerjeve të energjisë elektrike si shkak i mospagesave të konsumeve të matura për vitin 2017 për abonentët familjarë 1193 ndërprerje.

Perdorimi i energjisë elektrike për ngrohje në studimet e Bankës Botërore (cituar në studimin e ERE-se të Gushtit 2009 “Konsumi Energjisë Elektrike në Familje”) dhe Agjencia Kombëtare Energjisë (AKE) nuk konsiderohet si energji elektrike për plotësimin e nevojave jetësore, megjithatë në realitetin e vendit tonë alternativa e gazit të lëngshëm nga pikepamja e efikasitetit dhe anës ekonomike është një alternativë më e mirë për përdorimin në ngrohje.

Llogaritja e konsumit minimal të energjisë elektrike për një familje, është realizuar duke bërë matjen e individuale të çdo pajisjeje elektrike në përdorim. Matjet kryen me një aparat matës digital multifunksional i shkallës së saktësisë 1.0. Gjithashtu matjet kanë marrë në konsideratë dhe studimin e ERE-se, Gusht 2009 “Konsumi Energjisë Elektrike në Familje”. Më poshtë paraqitet përlogaritja e konsumit të çdo pajisjeje elektrike dhe totali mujor i konsumit.

Lloji i pajisjes elektrike	Konsumi Kwh/muaj
Ndricim elektrik	30
Frigorifer	22

Lavatrice	27
TV & Marres Satelitor	18
Gatim	50
Hekurosje	7
Ventilator	13
Ngrohje uji sanitar	45
<b>Totali</b>	<b>210</b>

Kjo shifër është krahasuar edhe me të dhënat e konsumit mesatar që rezultojnë nga aktmarrëveshjet e lidhura me familjet që trajtohen me ndihme ekonomike. Duke bërë një analizim të këtyre të dhënave zyrtare marre nga shoqëria “OSHEE” sh.a rezultoi se konsumi mesatar i energjisë elektrike i kësaj kategorie të abonenteve familjare për vitin 2017 është 2437 Kwh/vit ose mesatarisht 203 Kwh/Muaj.

Kjo shifër është në koherencë edhe me propozimet e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, për një përkufizim rajonal të klientëve të pambrojtur për Palët Kontraktuese Tetor 2013 (Komuniteti i Energjisë, 2015), ku përcaktohet niveli i konsumit të energjisë elektrike për person, palët kontraktuese duhet konsiderojnë konsumin total deri në 200 kWh/ muaj për një familje me deri në 4 anëtarë dhe që reflekton sezonalitetin.

**Ne lidhje me skemat për mbështetjen e abonentëve në nevojë sugjerojmë 2 alternativa të mundshme:**

Metodikisht kemi 3 mënyra për hartimin e politikës së çmimeve dhe të tarifave të energjisë për abonentët në nevojë, ndërkohë që në këtë material do të paraqesim 2 skemat me fizibilitet më të lartë.

**Skema 1**

Se pari, përmes kompensimit financiar nga ana e qeverisë të çmimit të energjisë elektrike për këto kategori abonentesh familjare për konsumin minimal të nevojshëm prej 210 kwh për familje. Referuar çmimit aktual të tarifimit të energjisë elektrike prej 9.5 lek/kwh, vlerësojmë se duhet të kemi një subvencionim prej 2,394.00 leke në muaj për familjet në nevojë sipas përkufizimit paraqitur më sipër.

Përben avantazh në aplikimin e kësaj skeme përvoja e akumuluar në subvencionimin e një pjese të shpenzimeve për energji elektrike si pasojë e heqjes së fashës mbrojtëse prej 300 KW/H në vitin 2015. Nga ana tjetër, kjo skeme mund të shoqërohet me një rritje të mundshme të barrës administrative për zbatimin efektiv të saj.

Me qëllim që subvencionin e akorduar për kompensimin e çmimit të energjisë elektrike të shërbejë për qëllimin për të cilin jepet, sugjerojmë që të bëhet kushtëzimi i shpërndarjes së kompensimit, me paraqitjen e mandat pagesës së fatures së muajit pararendes të energjisë elektrike nga ana e familjeve përfituese.

**Efekti financiar**

Parashikohet një ulje vit pas viti duke patur parasysh pastrimin e skemës së ndihmës ekonomike sikurse dhe efektivitetin në rritje të programeve të nxitjes së punësimit.

## **Skema 2**

Faturimi i energjise elektrike duke perdorur dy fasho konsumi, ku ne fashen e pare perfshihet konsumi minimal i energjise prej 200 kWh per plotesimin e nevojave themelore te "abonenteve ne nevojë", i cili do i kompesnohet direkt OSHEE-se, duke dekurajuar keshtu perdorimin e energjise per ngrohje.

Per rivendosjen e kesaj skeme, perben avantazh rritja e kapacitetit te administrates se OSHEE te konstatimit dhe parandalimit te rasteve të abuzimit me skemën e mundshme të vendosjes së fashës specifike për abonentët në nevojë (ndarjes artificiale e lidhjeve ne sistem në të njëjtën njësi ekonomike familjare ose ndarja artificiale e familje nga trangu familjar). Sistemi i ndihmës ekonomike është modernizuar duke rritur aftësinë e identifikimit ose parandalimit të abuzimeve të kësaj natyre duke ndihmuar tërthorazi dhe zbatimin efektiv të skemës përmes fashës së posaçme për familjet në nevojë. Nga ana tjetër, edhe kjo skeme mund të shoqerohet me një rritje të barrës administrative për zbatimin efektiv të saj.

## **Efekti financiar**

Parashikohet një ulje vit pas viti duke patur parasysh pastrimin e skemës së ndihmës ekonomike sikurse dhe efektivitetin në rritje të programeve të nxitjes së punësimit.

Te dyja metodat kane gjetur perdorim qofte ne planin nderkombetar dhe ate kombetar, por aktualisht ne te gjithë vendet e BE-se ka gjetur zbatim metoda e pare e tarifimit te energjise elektrike.

**Një mase tjetër të cilën e vlerësojmë të domosdoshme është edhe kthimi i aktmarrëveshjeve për familjet në nevojë** me qëllim për të rifitur në sistem ata abonente të cilët kanë dalë nga sistemi si pasojë e moszbatimit të aktmarrëveshjeve në kushtet e mungesës së mbrojtjes nga zbatimi i nenit 95 të ligjit nr. 43/2015 "*Per sektorin e energjise elektrike*", si dhe ato familje të cilat e kanë patur të pamundur që të lidhin një aktmarrëveshje. Skema e aktmarrëveshjeve duhet të krijojë mundësinë e shlyerjes me këste të debisë duke marrë në konsideratë aftësinë paguese të abonentit në nevojë. Skemat e mëpashme të aktmarrëveshjes nuk e kanë përmbushur plotësisht këtë përcaktim pasi një familje që trajtohej me rreth 6000 Leke ndihmë ekonomike në muaj duhet të shlyente 1200 Lekë këstin për debinë e akumuluar si dhe faturën korentë, fakt që e bënte të pamundur përballimin e kushteve të aktmarrëveshjes pasi në mjaft raste familjeve duhet të paguanin rreth 50% të të ardhurave në mujore për të përmbushur detyrimin<sup>2</sup>.

Gjithashtu, propozojmë që lidhja e kontratës dhe matësi i energjisë duhet të jetë pa pagesë për abonentët në nevojë pasi pagesa aktuale rezulton rreth 18,000 Lekë dhe në kushtet aktuale është pengesa e parë që duhet të kryejnë familjet që kërkojnë një lidhje të re me qëllim aksesin në shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

\*\*\*\*\*

Për çdo lloj komunikimi në lidhje me detajet e ndonjë seance të mundshme dëgjimore për projekt-vendimin në zbatim të nenit 95 të Ligjit 43/2015, jeni të lutur të na kontaktoni në adresën tonë të e-mailit: info@osfa.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

---

<sup>2</sup> Këtu i referohemi konsumit mesatar mujor në KWH të abonentëve familjar në nevojë që kanë lidhur aktmarrëveshje me OSHEE sha.

**Me konsideratë,**  
Andi Dobrush  
**Drejtorekzekutiv**